



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



BULETINI DITOR I FSSHM-së

PËRMBLEDHJE INFORMACIONESH NGA LËMIA E SHËNDETËSISË TË MARRA NGA SHTYPI DITOR DHE MEDIUMET ELEKTRONIKE

11 Dhjetor 2015



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Rritja e kapitacionit të stomatologëve amë



Fondi për sigurim shëndetësor i Maqedonisë për t'a përmirësuar gjendjen e përgjithshme të veprimtarisë në fushën e stomatologjisë ka identifikuar tre segmente që janë të nevojshme për t'u avansuar. Segmenti i parë i dedikohet mjeteve financiare të kujdesit shëndetësor parësor (KSHP), segmenti i dytë ka të bëjë me rregullimin e marrëdhënieve reciproke mes Fondit dhe ordinancave stomatologjike dhe segmenti i tretë i dedikohet kujdesit shëndetësor terciar gjegjësisht pagave të stomatologëve specialist.

Në lidhje me segmentin e parë me kënaqësi Ju informojë se, prej 1 Janar 2016 Fondi do t'a rrisë pikën e kapitacionit nga 35 denarë në 40 denarë gjegjësisht rritje për 14%. Rritja e vlerës 5 denarëshe, për Fondin kushton mjete të ndara shtesë për 75,3 milion denarë në vit. Në vitin 2015 janë parashikuar dhe do të paguhen mjete me vlerë prej 524 milion denarë ndërsa me rritjen e vitit 2016 gjegjësisht të 75,3 milion denarëve, Fondi do të paguajë gjithsej 599,3 milion denarë në vit për stomatologët amë.

Përfitimim e kësaj mase do t'i ndejnë 1.146 time që punojnë nëpër 963 ordinanca stomatologjike dhe gjithsej 1.312.300 pacient që kanë të përzgjedhur stomatolog amë. Mesatarisht çdo stomatolog amë ka nga 1.145 pacientë.

Ky vendim i Fondit i verifikuar nga Bordi Zgjedhor dhe me miratimin e Ministrisë së Shëndetësisë do të shpallet në Gazetën Zyrtare të RM-së.

Segmenti i dytë i dedikohet aneks marrëveshjeve të reja për vitin 2016 për zbutjen e dënimeve kontraktuale që është lehtësim i madh në punën e përditshme të stomatologëve amë.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Segmenti i tretë i dedikohet pagave të kujdesit shëndetësor terciar në fushën e stomatologjisë. Përkrah llojit të shërbimeve shëndetësore që ofrohen në këtë nivel, e kemi parë të arsyeshme që pagat e stomatologëve specialist që punojnë në Qendrën Klinike Stomatologjike të rriten për 20%.

Fondi për sigurim shëndetësor i Maqedonisë do të vazhdojë të jetë partner serioz dhe bashkëpunëtor lojal me institucionet shëndetësore për përforcimin dhe sigurimin e shërbimeve shëndetësore kualitative për të gjithë së siguruarit dhe kushtve kualitative të punës për punonjësit shëndetësor.



Rriten kontributet financiare të stomatologëve, 40 denarë për një pacient



Shkup, 10 dhjetor - Ministria e Shëndetësisë ka vendosur që nga viti i ardhshëm të mbështesë veprimtarinë e stomatologëve, duke i rritur kontributet e tyre financiare prej 35 në 40 denarë për një pacient.

Autoritet shëndetësore me këtë risi presin motivim të madh të dentistëve gjatë kryerjes së punës së tyre dhe përmirësimin e imazhit për mbrojtjen shëndetësore dentare të qytetarëve.

“Kjo është një risi e rëndësishme e cila do të mundësojë benefit financiar për stomatologët amë dhe motivimin e stomatologëve të rinj të cilët tani fillojnë të punojnë”- deklaroi ministri i Shëndetësisë, Nikolla Todorov.

Mjetet për rritjen e kontributeve të stomatologëve janë të siguruara nga buxheti i Fondit për Sigurim Shëndetësor.

“Nga 1 janari 2016 fondi do të rrisë pikën e kapitacionit nga 35 në 40 denarë, gjegjësisht do të ketë rritje për 14 për qind. Rritja me vlerë prej 5 denarëve për stomatologët për fondin kushton mjete të ndara shtesë prej 75, 3 milion denarë në vit”- tha drejtori i FSSHM-së, Orhan Ramadani.

Me këtë risi priten të përfitojnë gjithsej 1 mijë e 146 ekipe stomatologësh. Sipas të dhënave, mesatarisht një stomatolog amë në vend ka rreth 1100 pacientë.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Ndihmoni Semirit të vogël nga Sellca, vuan nga smundja e eshtrave

Shkup, 10 dhjetor - Familja shtatë antarëshe Saliut nga fshati Sellcë i Tetovës, është në gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale pa kushtet minimale për të bërë një jetë normale. Në këtë familje stinët janë të njejta, pothuasje aty asnjëherë nuk depërton dielli që të ngroh, por edhe ditët e dimrit janë të vështira dhe të papërbalueshme.

Kur kësaj familje i shtojmë edhe sëmundjet atëherë gjendja është dyfish më e rëndë. Kyefamiljari Shefajet Saliu, ka mbi supe një barrë të rëndë duke u përballur me varfërinë e skajshme dhe sëmundjen e djalit të tij të vogël Semiri.

Nuk janë vetëm kushtet ekonomike një brengë për kryefamiljarin Shefajet Saliu, brenga më e madhe e tij është njëri nga djemtë e tij Semiri i cili vuan nga sëmundja e eshtrave, mjekët kanë dhënë shpresë se nëse mjekohet në një nga spitalet e Ohrit ai edhe mund të shërohet deri në 80% mund të ecë vetë, por gjendja financiare e kryefamiljarit nuk ia mundëson dot mjekimin Semirit të vogël, prandaj Shefajet Saliu apelon deri tek të gjithë ata njerëz human, bamirës, biznesmen që varësisht mundësive që kanë ta ndihmojnë, që të ia zgjasin dorën, njofton Tv Koha.

Shoqata humanitare “Shtëpia M” në bashkëpunim me qytetarë human, bamirës kompani private, ka ndërmarë një iniciativë që kësaj familje të ia ndërtojnë një shtëpi, punimet për ndërtimin e shtëpisë kanë arritur deri në fazën e parë, por për shkak të mungesës së materialit ndërtimorë kanë ngecur, andaj kryefamiljari

Shefajet Saliu edhe njëherë ju drejtohet të gjitha ndërmarjeve, bizneseve, për të ia zgjatur dorën ta ndihmojnë në forma të ndryshme, me material ndërtimorë për ndërtimin e shtëpisë, me mjete financiare që edhe ai me familjen e tij të ketë një shtëpi për shkak se me gjashtë anëtarët e tjerë jeton në një dhomë, bodrum në kushte të vështira, por proritare për Shefajetin është shërimi i djalit Semirit të vogël.

Një nxënës i infektuar nga tuberkulozi

Shkup, 10 dhjetor – Një nxënës të vitit të tretë në shkollën e mesme “Zef Lush Marku” në Shkup, i është diagnostikuar sëmundja e tuberkulozit. Ai që nga dita e hënë është në kurim spitalor në institutin për TBC.

Nga Shtëpia e shëndetit në Shkup, e konfirmojnë informacionin dhe rekomandojnë se meqë nxënësi ka qenë në kontakt me më shumë persona, kompetentët të ndërmarrin masa në mënyrë që të parandalojnë përhapjen eventuale të sëmundjes.

Kontroll duhet të bëjnë të gjithë 25 nxënësit e klasës së tij. Pas diagnostikimit të rastit, Qendra për Shëndet Publik në Shkup dhe Inspektorati Shtetëror Sanitar menjëherë kanë bërë këqyrje në shkollë. Nuk kanë gjetur vërejtje, por kanë rekomanduar të rritet ajrosja dhe të mirëmbahet higjiena personale.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Sot është bërë dhe dezinfektimi i shkollës. Megjithëse tuberkulozi është në rënie, sipas epidemiologëve nuk është tipike që në shekullin 21 kjo sëmundje të shfaqet në zonat urbane. Mbrojtja më e mirë është vaksinimi.



Rriten kontributet financiare të stomatologëve, 40 denarë për një pacient



Prej një janar 2016 do të rritet kontributi financiar i stomatologëve amë, që jepet nga Fondi për Sigurim Shëndetësor...

Ministria e Shëndetësisë ka vendosur që nga viti i ardhshëm të mbështesë veprimtarinë e stomatologëve, duke i rritur kontributet e tyre financiare prej 35 në 40 denarë për një pacient.

Autoritet shëndetësore me këtë risi presin motivim të madh të dentistëve gjatë kryerjes së punës së tyre dhe përmirësimin e imazhit për mbrojtjen shëndetësore dentare të qytetarëve.

“Kjo është një risi e rëndësishme e cila do të mundësojë benefit financiar për stomatologët amë dhe motivimin e stomatologëve të rinj të cilët tani fillojnë të punojnë”- deklaroi ministri i Shëndetësisë, Nikolla Todorov.

Mjetet për rritjen e kontributeve të stomatologëve janë të siguruara nga buxheti i Fondit për Sigurim Shëndetësor.

“Nga 1 janari 2016 fondi do të rrisë pikën e kapitacionit nga 35 në 40 denarë, gjegjësisht do të ketë rritje për 14 për qind. Rritja me vlerë prej 5 denarëve për stomatologët për fondin kushton mjete të ndara shtesë prej 75, 3 milion denarë në vit”- tha drejtori i FSSHM-së, Orhan Ramadani.

Me këtë risi priten të përfitojnë gjithsej 1 mijë e 146 ekipe stomatologësh. Sipas të dhënave, mesatarisht një stomatolog amë në vend ka rreth 1100 pacientë.